



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 419/1 prot.

Tiranë, më 24.04.2019

VENDIM

Nr.41, datë 24.04.2019

PËR

PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR.90, DATË 13.11.2018, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË CËRRIK

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 90, datë 13.11.2018, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Cërrrik dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Urdhrin nr. 28, datë 18.02.2019, *“Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”*, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 90, datë 13.11.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Cërrrik.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, nëpërmjet vendimit nr. 65, datë 11.06.2018, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë*

Cërrik”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Cërrik.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas përfundimit të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 515/6 prot., datë 13.11.2018, ka dërguar pranë Bashkisë Cërrikraportin përfundimtar lidhur me administrimin e shërbimit civil dhe vendimin paralajmërues nr. 90, datë 13.11.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës dhe një afat prej 60 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe në detyrat e lëna për Bashkinë Cërrik, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, grupi i punës, hartoi Akt-Konstatiminatedatës 25.03.2019, ku analizohet situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në Vendimin Nr. 90, datë 13.11.2018, të Komisionerit, si më poshtë:

Konstatohet se janë zbatuar orientimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe **në pikën 2**, të vendimit të paralajmërimit nr. 90, datë 13.11.2018, të Komisionerit, që ka lidhje me deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit ka finalizuar procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e mëposhtëm:

- ✓ *****, me aktin nr. 674/3 prot., datë 15.02.2019, është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”;
- ✓ *****, me aktin nr. 674 prot., datë 15.02.2019 është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin e punës, “Specialist Invaliditeti, pranë Njesisë Cërrik, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”;
- ✓ *****, me aktin nr. 674/2 prot., datë 15.02.2019 është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”;
- ✓ *****, me aktin nr. 674/1 prot., datë 15.02.2019 është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin e punës, “Specialiste për Barazinë Gjinore të shtresave në Nevojë dhe Politikat e Punësimit, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”.

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues, është kërkuar konstatimi i pavlefshmërinë absolute të akteve për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Kryetari i Bashkisë Cërrik, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe ka rregulluar pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke nxjerrë urdhrat përkatës për punonjësit e mëposhtëm:

- ✓ *****, me detyrë, “Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm”, është liruar nga detyra me urdhrin nr. 386, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Specialiste e Sektorit të Auditimit të Brendshëm” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 387, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 388, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Specialist Informimi, në Njësinë Administrative, Cërrik, në Sektorin e Informimit me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 389, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Specialist Informimi, në Njësinë Administrative, Klos, në Sektorin e Informimit me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun” është liruar nga detyra me urdhrin nr.390, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Specialist Informimi, në Njësinë Administrative, Mollas, në Sektorin e Informimit me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 391, datë 31.12.2018; *****, me detyrë, “Specialiste Kontabiliteti, në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 392, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Specialiste Mjedisi, në Sektorin e MMT dhe Kadastrës Ligjore, në Drejtorinë e Bujqësisë, MMT, Mjedisit, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 393, datë 31.12.2018;
- ✓ *****, me detyrë, “Përgjegjës i Sektorit të Aplikimit të Projekteve, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve” është liruar nga detyra me urdhrin nr. 394, datë 31.12.2018.

Konstatohet se njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, pranë Bashkisë Cërrik, ka zbatuar orientimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe **në pikën 4**, të Vendimit të paralajmërimit nr. 90, datë 13.11.2018, të Komisionerit, duke plotësuar formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018,

për çdo nëpunës civil. Gjithashtu ka orientuar edhe aktorët e tjerë të procesit, ndër të cilët eprorët e drejtpërdrejtë, si dhe ka përfshirë në Regjistrin Qendror të Personelit të gjithë formularët e vlerësimit për çdo nëpunës civil.

Gjatë verifikimit pranë subjektit u konstatua se formularët e vlerësimit të punës ishin plotësuar konform kërkesave të ligjit për të gjithë nëpunësit civilë të institucionit.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se, nga ana e njësisë përgjegjëse janë marrë të gjitha masat për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 90, datë 13.11.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Cërrik dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Cërrik, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 90, datë 13.11.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Cërrik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha